



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh. II.nr.966/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare, Sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1.Kompania N.T.P “Mazreku”-Petrol-3, me seli në Malishevë, 2. A... M..., 3. V... M... dhe 4. S... M..., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të parë Kompania N.T.P “Mazreku”- Petrol-3, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 418/22 të datës 27.03.2023, me datë 21.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Kompania N.T.P “Mazreku”-Petrol-3, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 418/22 të datës 27.03.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr. 418/22 të datës 27.03.2023, ne dispozitiv e këtij aktvendimi ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania N.T.P “Mazreku”-Petrol-3, ushtruar kundër urdhrit, P.nr.104/19 të datës 31.05.2019, të lejuar nga Përmbartuesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë Kompania N.T.P “Mazreku”-Petrol-3, (me pretendime sikur në ankesë) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje

Ekonomike, KPPP.nr. 418/22 të datës 27.03.2023, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ne ankesë duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në ankesë duke arsyetuar se urdhri për lejimin e përmbarimit është në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së andaj, Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Dytë i ka propozuar që ankesën e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Banka Kombëtare Tregtare, Sh.a, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumenteve përmbarimore Marrëveshjes mbi Pengun Nr.7977/16 të datës 21.12.2016, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimet e Pengut R-20170106-267 të datës 06.01.2017, Marrëveshjes mbi Pengun Nr.7977/16 të datës 07.08.2017 e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit për Regjistrimin e Pengut R-20170809-147 të datës 09.08.2017 dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.Nr.7054/2016, Ref.Nr.31932/2016 të datës 21.12.2016 e regjistruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës me numër prot. Nr.06-839-2016 e datës 22.12.2016 për sigurimin e kërkesave nga Kontrata e Kredisë Bankare, Nr.7977/16 e datës 21.12.2016, duke detyruar debitorët që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguajnë borxhin në shumën prej 78,267.25€.

Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.104/19, dt.31.05.2019 e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke theksuar se urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori, me të cilin ka theksuar se urdhri për lejimin e përmbarimit është në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit kurse urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimi, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr. 418/22 të datës 27.03.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kompania N.T.P “Mazreku”-Petrol-3, ushtruar kundër urdhrin, P.nr.104/19 të datës 31.05.2019, të lejuar nga Përmbaruesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se prapësimi i palës debitore është i bazuar pasi që dokumentet në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente përmbaruese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara ë përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Ligjit për Procedurën Përmbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku në mesin e dokumenteve përmbarimore në bazë të

cilave organi përmbareues mund të caktoj përmbarimin është edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimet ankimore të debitorit se aktvendimi i ankimuar është marrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se në rastin konkret përmbareuesi privat e ka lejuar përmbarimin duke u bazuar në Marrëveshjes mbi Pengun Nr.7977/16 të datës 21.12.2016, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimet e Pengut R-20170106-267 të datës 06.01.2017, Marrëveshjes mbi Pengun Nr.7977/16 të datës 07.08.2017 e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit për Regjistrimin e Pengut R-20170809-147 të datës 09.08.2017 dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbareuese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbareimore, Ligjit për Procedurën Përmbareimore me të cilën parashihet se *“1. Dokumente përmbareuese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”* ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbareimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbareimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SE DYTË

K.DH.SH.II nr.966/23 me datë 21.11.2023

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri